

VENDIM
Nr. 580, datë 11.10.2023

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË TEK MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT,
PËR FONDACIONIN “DURRAH CITY FOOTBALL ACADEMY”, TË PRONAVE
SHTETËRORE ME NUMËR PASURIE 79/1 DHE 80/1, PJESË E ZONËS
KADASTRALE NR. 8517, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE
DURRËS, PËR NDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN E KOMPLEKSIT TË
AKADEMISË SË FUTBOLLIT DURRËS, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 262, DATË 6.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË
SPITALLË, DURRËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pronave shtetërore me numër pasurie 79/1, me sipërfaqe 99 770 m², dhe 80/1, me sipërfaqe 104 580 m², pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e Spitallës, sipas kartelave të pasurive dhe fragmenteve të hartës kadastrale, në aneksin 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për vënien në dispozicion të fondacionit “Durrah City Football Academy”, me qëllim ndërtimin dhe zhvillimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës.

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të përdoren për ndërtimin dhe zhvillimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës, të ambienteve sportive dhe çdo shërbimi të nevojshëm, në funksion të promovimit dhe zhvillimit të sportit të futbollit në Republikën e Shqipërisë, si dhe realizimin e funksioneve të fondacionit “Durrah City Football Academy”.

3. Në listën e pasurive që përfshihen në sipërfaqen e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik, bashkëlidhur vendimit nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës”, të ndryshuar, hiqen pronat shtetërore të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, fondacioni “Durrah City Football Academy” dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8517026134

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8517, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 79/1, Sipërfaqja Totale 99770 m²,
(Nga të Cilat Truall 99770 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-87(239-D)87(255-B), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia SPITALLE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI, Nr. Identifikimi/NIP'i SG3965115085, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00007549, Datë: 06/01/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dënuat e Aktit			Akti i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtimi	Nr.	Data		Emër Aktit Mbrojtës	Nr. Identifikimi NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dënuat e Aktit			Akti i Kufizimit	Përfitues/Kërkuar	
			Emërtimi	Nr.	Data		Emër Aktit Mbrojtës	Nr. Identifikimi NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: VIJON NGA VOL.4, FQ.192

DREJTORI
Ilir Gjinali

Erion
Rrushi

Digitally signed by
Erion Rrushi
Date: 2023.09.07
17:46:39 +02'00'

Leandro
Dervishi

Digitally signed by
Leandro Dervishi
Date: 2023.09.07
17:50:12 +02'00'

Ilir
Gjinali

Digitally signed by
Ilir Gjinali
Date: 2023.09.07
18:05:23 +02'00'



Vleruar elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Dumes
Data: 2023/09/07 13:46:11 +02'00'
K02231002940223090713440473A29K

Duke: Ky dokument është gënjyeshëm dhe vlerësohet si i tillë
si një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shqiptare e Kadastresë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 8517

KODI UNIK: 8517026134

NUMRI PASURISË : 79/1

INDEX I HARTËS: K-34-87-(255-B)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



DREJTORI
ILIR GJINALI

Leandro
Data 07/11/2023

SH 1: 5000
Digitally signed by:
ilirgjinali
Date: 2023.09.07
08:18:39 +0200

SHPJEGUES

- ☐ PARCELA
- ☐ NDERTESA



Vetëverifikimi nga Drejtoria
Verifikuar Durrës
Data: 2023.09.07 16:26:50 +0200
80223100142023090716163401614

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe verifikuar me një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHITETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8517026136
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8517, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 80/1, Sipërfaqja Totale 104580 m²,
(Nga të Cilat Truall 104580 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-87(239-D)87(255-B), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia SPITALLE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE NE PERGJEGJESI ADMINISTRIM, Nr. Identifikimi/NIPT SG3965115085, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i

Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00007549, Datë: 06/01/2021

*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Drejtës	Titulli i Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtimi	Nr.	Datë		Emër Aktit Mbledhës	Nr. Identifikimi NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Titulli i Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkuar	
			Emërtimi	Nr.	Datë		Emër Aktit Mbledhës	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: VIJON NGA VOL.4, FQ.193

DREJTORI
Ilir Gjinali



Vukosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Durrës
Date 2023/09/07 13:44:52 +02'00'
8022316009642300013444015ASHK

Erion
Rrushi

Digitally signed by
Erion Rrushi
Date: 2023.09.07
07:15:38 +02'00'

Leandro
Dervishi

Digitally signed by
Leandro Dervishi
Date: 2023.09.07
07:15:38 +02'00'

Datore të kufizimit
Gjinali

Digitally signed by
Ilir Gjinali
Date: 2023.09.07
07:15:38 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 8517

KODI UNIK: 8517026136

NUMRI PASURISË : 80/1

INDEX I HARTËS: K-34-87-(255-B)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



DREJTORI
ILIR GJINALI

Leandro
Data 07/09/2023

SH 1: 1000
Digitally signed by:
Ilir Gjinali
Date: 2023.06.07
09:14:33 +0200

SHPIEGUES

□ PARCELA
□ NDERTESA



Vulazur elektronik nga Drejtoria
Vendosa Dures
Data 2023/06/07 16:31:20 +0200
K02231032H42623000716211344014

Shënimi: Ky dokument është gjeneruar dhe vulazur me anë

Ministrul de Vădăritate KKT, Nr.2, data 02.07.2024

LEJE NDËRTIMI INFRASTRUKTURE PËR OBJEKTIN:
MBYLLJA E VËNDDEPOZITIMIT EGZISTUES TË MBETJEVE TË NGURTA DHE NDËRTIMI I ECO-PARK DURRES



PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS SHK. 1:1000



POZICIONI KADASTRIAL SHK. 1:2000



HARTA TOPOGRAFIKE SHK. 1:2000



TREGUESIT E ZHVILLIMIT:

Sipërfaqe e përgjithshme e muallit: 149.122 m²
Sipërfaqe e muallit që përdoret për zhvillim: 149.122 m²
Sipërfaqe e muallit që zëvendësohet nga struktura (gjurmja): 813 m²
Sipërfaqe e zërë nga struktura dhe nga zivështja: 1 kat (gjurmja): 110,7 m²
Sipërfaqe e zërë nga struktura bar kafe: 1 kat (gjurmja): 500 m²
Sipërfaqe e zërë nga struktura ambiente teknike (gjurmja): 202,3 m²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit: 1544 m²
Koefficienti i shfrytëzimit të muallit për ndërtim: 55%
Intensiteti i ndërtimit: 0,01
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kështjës së sistemit: 29,2 m
Numri i katëve shtesë: 0
Numri i katëve shtesë: 0

PRONËSIA:

Zona Kadastrale: 8517
nr. parcelle 36 Vol 4 fq 150
nr. parcelle 37 Vol 4 fq 151
nr. parcelle 338/1 dhe 338/2

KUTIZIMI:

Vendi: Me pronësi me nr. parcelle 344/3
Rug: Me pronësi me nr. parcelle 332/1
Lindje: Me pronësi me nr. parcelle 339/2
Perëndim: Me pronësi me nr. parcelle 337/1

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T

Z. EDI RAMA

Znj. BELINDA BALLUKU
Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë

Miratuar me Vendim të KKT Nr. 06, Datë 13/01/2020		
LEJE NDËRTIMI INFRASTRUKTURE PËR OBJEKTIN: "MBYLLJA E VËNDDEPOZITIMIT EGZISTUES TË MBETJEVE TË NGURTA DHE NDËRTIMI I ECO-PARK DURRES"		
EMËRTIMI I LLETËS	Plani i vendosjes së strukturës së muallit dhe vendosjes së infrastrukturës së muallit dhe ndërtimit të objektit të ndërtimit	
PROJEKTOHET	Agencia Kombëtare e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit - ASZP	
PROJEKTOHET	TALLANT/2014	
ZHVILLUES	Agencia Kombëtare e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit - ASZP	
PAZA E PROJEKTOHET	PROJEKT - ZHVILLIM	
SHKALLA 1:1000	SH. I PLANIT A3/1	SH. I PLANIT 1:2000

Njoftimi i Ftesës për Propozim

Organizatori: Fondacioni "Dyrrah City Football Academy"
Projekti: "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës"
Titulli i kontratës: "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës"
Dërguar më: 2 Shkurt 2024

Drejtuar klubeve të Kategorisë "Abissnet Superiore"

- Fondacioni "Dyrrah City Football Academy", këtu "Fondacioni", zhvillon projektin "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës", i cili ka për qëllim zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Manchester City Football Club Limited dhe Fondacionit.
- Fondacioni, i themeluar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si edhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 11.10.2023, shpall këtë procedurë për përzgjedhjen e një Klubi Futbollit, anëtar i Federatës Shqiptare të Futbollit, në kategorinë "Abissnet Superiore", këtu "Klubi", me qëllim bashkëpunimin për financimin dhe realizimin e projektit "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës".
- Fondacioni fton propozime të vullosura nga të gjitha klubet pjesëmarrëse në kategorinë "Abissnet Superiore", të renditura alfabetikisht në vijim:
 - Klubi "Dinamo City"
 - Klubi "Egnatia"
 - Klubi "Erzeni"
 - Klubi "Kukësi"
 - Klubi "Laçi"
 - Klubi "Partizani"
 - Klubi "Skënderbeu"
 - Klubi "Teuta"
 - Klubi "Tirana"
 - Klubi "Vllaznia"
- Përzgjedhja do të kryhet nepermjet një procedure konkurrese, siç specifikohet në seksionin "Udhëzimet për Kandidatët", në Ftesën për Propozim, bashkëngjitur këtij njoftimi dhe është e hapur për të gjithë kandidatët e ftuar.
- Ftesa për Propozim do të dërgohet nepermjet emailit në adresën e kandidatëve të ftuar në pikën 3 të këtij njoftimi.

6. Propozimi do të përbëhet nga formularët e kërkuar, të ndarë në dy zarfe, siç detajohet në Udhëzimet për Kandidatët, në Ftesën për Propozim.

7. Propozimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur, në adresën:

Fondacioni "Dyrrah City Football Academy"
Rr. "Përrit Kokalari", Nr. 57
Kompleksi Sportiv
1012, Tiranë
Kujtim Rushiti – Person Kontakti
00355697873037
info@dcfa.al
www.dcfa.al

në ose përpara datës 23/02/2024, ora 12:00.

8. Propozimet e marra pas afatit të sipërpërmendur do të refuzohen.

9. Propozimet do të hapen publikisht, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të kandidatëve dhe kujdo që dëshiron të marrë pjesë në adresën, datën dhe orën e sipërpërmendur.

10. Ju lutemi konfirmoni menjëherë me shkrim marrjen e kësaj shkrese në rrugë elektronike në adresën e mëposhme:

info@dcfa.al
Kujtim Rushiti – Person Kontakti
00355697873037
Fondacioni "Dyrrah City Football Academy"

11. Nëse nuk dëshironi të paraqisni propozim, ne do të vlerësojmë që të njoftoheshim me shkrim nga ana juaj sa më shpejt që të jetë e mundur në adresën e emailit të dhënë më sipër.

Për Fondacionin,

Gjergj Ndoci

Drejtor Ekzekutiv



DYRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY

24.04.2024

NJOFTIM FITUESI

Fondacioni "Dyrrah City Football Academy" (më tej referuar si "Fondacioni") njofton mbylljen e procedurës konkurruese për zgjedhjen e Klubit të Futbollit, anëtar i Federatës Shqiptare të Futbollit, në kategorinë "Abissnet Superiore", i cili do të financojë ndërtimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës. Klubi fitues është "Futboll Club Dinamo City" sh.a. (më tej referuar si Klubi "Dinamo City").

Fondacioni publikoi Ftesën për Propozim më datë 2 shkurt 2024, ku ftoi propozime të valosura nga të gjitha klubet pjesëmarrëse në kategorinë "Abissnet Superiore". Në konkurrim paraqiti propozim një Kandidat, Klubi "Dinamo City".

Në bazë të Ftesës për Propozim, kriteri përzgjedhës i propozimit fitues është propozimi që ofron afatin më të shkurtër të përfutimit të të ardhurave nga të ardhurat e marra nga transferimi dhe huazimi i lojtarëve të Akademisë së Fondacionit dhe kompensimit për trajnim dhe solidaritet, brenda afatit maksimal të përcaktuar si 120 (njëqind e njëzet) muaj, nga data e firmosjes së kontratës ndërmjet Fondacionit dhe Kandidatit të suksesshëm.

Propozimi i paraqitur nga Klubi "Dinamo City" u shqyrtua në tërësi, dhe rezultoi se Klubi "Dinamo City" plotëson kriteret dhe kushtet e kualifikimit, si dhe ka paraqitur një propozim të vlefshëm duke ofruar një afat prej 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) muaj. Si rezultat, "Futboll Club Dinamo City" sh.a. shpallet fitues për zbatimin e kontratës "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës" në përputhje të plotë me dokumentacionin e Ftesës për Propozim, dhe çdo shtojcë të saj.

Kontrata "Ndërtimi i kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës" e lidhur ndërmjet Fondacionit "Dyrrah City Football Academy" dhe Dinamo City Football Club sh.a. parashikon se Klubi do të rimbursohet nga të ardhurat e përfutura nga transferimi dhe huazimi i lojtarëve

Rr. Petrit Kokalari, Nr. 57, Tiranë
Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës

+355 69 99 48 675

info@dcta.al

www.dcta.al

NIPIT:
M3220202701W



DYRRAH CITY
FOOTBALL ACADEMY

të Akademisë së Fondacionit dhe kompensimet për trajnim dhe solidaritet, siç janë parashikuar në "Rregulloren për statutin dhe transferimin e Lojtarëve" të FSHF dhe FIFA, si dhe të drejtat e përdorimit të infrastrukturës dhe ambienteteve të Kompleksit të Akademisë Durrës, pa pagesë, në përputhje me Marrëveshjen e Posaçme, në këmbim të financimit të projektit dhe ndërtimit të infrastrukturës me kapacitetet e Klubit.

Gjergj
Ndoci

Drejtori Ekzekutiv DCFA
Gjergj NDOCI

Fondacioni "Dyrrah City Football Academy"
Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës

Rr. Petrit Kokalari, Nr. 57, Tiranë
Rr. Mujo Ulqinaku, Durrës

+355 69 99 48 675

info@dcta.al

www.dcta.al

NIPIT:
M3220202701W

KONTRATË SHITBLERJE AKSIONESH

NË LIDHJE ME SHITBLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË
FUTBOLL CLUB DINAMO CITY SH.A

E LIDHUR NDËRMJET

Z. ADRIAN BARDHI
(në cilësinë e Shitësit)

dhe

Z. ERGYS AGASI
(në cilësinë e Blerësit)

KONTRATË SHITBLERJE AKSIONESH

NË Durrës, sot më datë 31.03.2024 (TRIDHJET E NJE, ZERO TRE, DY MIJË E NJEZET E KATËR), NËNSHKRUHET KJO KONTRATË MIDIS PALEVE SI MË POSHTË,
NË LIDHJE ME SHITJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË AKSIONARE:

- "FUTBOLL CLUB DINAMO CITY" Sh.A. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit NUIS - M12121037S, me seli në adresën Rruga "Asli Gogoli" Lagja nr.14, Pasuria me nr.5/104, Vol.9, faqe 214, ZK.8516, Durrës, Shqipëri,

Nënshkruar midis:

- Z. Adrian Bardhi, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më datë 24.08.1970, identifikuar me dokumentin e identifikimit pasaportë me numër BC8084591 dhe numër personal H00824167H, (në vijim "Shitësi"); dhe
- Z. Ergys Agasi, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më datë 22.03.1987, identifikuar me dokumentin e identifikimit Pasaportë, me numër BE4087839 dhe numër personal I70322075Q, (në vijim "Blerësi");

Në vijim Shitësi dhe Blerësi bashkërisht do të quhen "Palët" dhe veçmas "Pala".

PARASHTRIME

MEQENËSE:

- "FUTBOLL CLUB DINAMO CITY" Sh.A. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit NUIS - M12121037S, me seli në adresën Rruga "Asli Gogoli" Lagja nr.14, Pasuria me nr.5/104, Vol.9, faqe 214, ZK.8516, Durrës, Shqipëri;
- Sic rezulton nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit bashkëlidhur si pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 73.500.000,00 (shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind mijë) Lekë, dhe zotërohet 100 % nga aksioneri i votëm (Shitësi);
- Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi t'i shesë Blerësit gjysmën e pjesëmarrjes së tij në Shoqërisë, që përfaqëson 30% të kapitalit të saj;
- Më datë 26.03.2024 Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë ka vendosur të miratojë transferimin e 30% të kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi, në favor të Blerësit.

ATËHERE, duke patur parasysh sa me sipër Palët lidhin këtë kontratë sipas kushteve vijuese: